



**V E N D I M**  
**Nr. 53 Datë 23.05. 2008**  
**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PER DISA NDRYSHIME NE KODIN E**  
**FUNKSIONIMIT TE SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE, KODIN E**  
**SISTEMIT TE TRANSMETIMIT, DHE KODIN E MATJES SE ENERGJISE**  
**ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, dhe 55 të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar, nenit 18, pika 1, germa g, dhe nenit 26, te Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, te miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 44, datë 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23/ 05/2008, pasi u njoh me propozimin e Drejtorise se Licensimit dhe Monitorimit te Tregut dhe Drejtorise Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, per disa ndryshime ne Kodin e Funkcionimit te Shperndarjes se Energjise Elektrike, Kodin e Sistemit te Transmetimit dhe Kodin e Matjes se Energjise Elektrike,

**VENDOSI :**

1. Fillimin e proçedurave per disa ndryshime ne Kodin e Funkcionimit te Shperndarjes se Energjise Elektrike, Kodin e Sistemit te Transmetimit dhe Kodin e Matjes se Energjise Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit te Tregut si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, për ndjekjen e procedurave ligjore per miratimin e ketyre akteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**